



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

## KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 060/01-42254

Pejë, datë: 30 qershor 2025

### PROCESVERBAL

Nga takimi i -V- i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **30 qershor 2025** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i kornizës z. Gazmend Muhamheri, nënkyetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtori i SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative z. Donjeta Morina; përfaqësuesit e ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin përendin e ditës dhe i sqaroj pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 31 anëtarë prezent. Gjithashtu sqaroj që piken 3. Procesverbalin e seancës KK-Pejë dt.29.05.2025, e tërheqim nga rendi i dites për shqyrtim dhe miratim në seancën tjeter.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 31 vota pro, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

### REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.05.2025.
3. Shqyrtimi dhe aprosim i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i grupit punues përhartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës përvitës 2026.
5. Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
6. Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.

7. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar;
8. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

### **1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.**

Në takim munguan z.Rrustem Berisha, znj.Leonora Shala, z.Granit Kelmendi, dhe znj. Fjolla Dembogaj.

### **2.Pjesëmarrja pë blike dhe delegacionet**

Nuk ka pasur.

### **3.Shqyrtimi dhe tprovim i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fillimishtë kornizen afatmesme buxhetore e kemi dërgu si material ashtu siq ka ardh nga ministria korniza buxhetore e komunës së Pejës. Pastaj e kemi dëguar edhe materialin e përpunuar nga Drejtorit për Financa si material përfundimtar përkornizen afatmesme buxhetore.

Znj.Diellza Berisl a: korniza afatmesme buxhetore është një dokument që miratohet çdo vit nga asambleja komunale. Hartimi i saj është një detyrim për institucionet komunale buxhetore që bëhet në përputhje me qarkoren buxhetore të aprovuar nga Ministria e Financave, punëve dhe transfereve. Prosesi i zhvillimit të kabit komunal përfshin katër faza kryesore me afate kohore përkatëse. Muaji naj, draftimi i kabit. Me çraست kryetari i komunës ka nxjerrë një vendim për themelimin e grupit punues për kab dhe procesin e dëgjimeve buxhetore. Duke qenë se jam pjesë e grupit punues, nië lejoni t'ju informoj se gruپi punues ka mbajtur takimet e tyre dhe kanë bërë edhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për procesin e dëgjimeve buxhetore. Si grup punues jemi në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues dhe ekspertë të çështjes së buxhetit nga Demosi, me qëllim që koruna e Pejës të ketë një proces të planifikimit të buxhetit sa më të mirë dhe konform rregulloreve në fuqi. Muaji qershori përfshin konsultimet publike me çraست si drejtorat kemi mbajtur kon sultim publik me qytitarët e komunës së Pejës. Po ashtu në qershori aprovohet kabit, data për aprovim është deri me 31 qershor. Pas aprovimit të kabit kalojmë te procesi i dëgjimeve buxhetore. Ne si grup punues së bashku me kryetarin e Pejës kemi vendosur t'i mbajm 10 dëgjime buxhetore neper zona të Komunës së Pejës me qytetarë

### **4.Shqyrtimi dhe miratimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: siç e dini bazë rregullore çdo vit jemi të obliguar që të aprovojmë planin e punës së kuvendit për vitin e ardhshëm. Gjithashtu obligohemi t'a miratojmë grupin punues që ka të bëj me draftimin e këtij plani të punës.

Propozimet e grupit punues:

Z.Islam Husaj- LDK

Znj.Vjendita Kelmendi Gërgoci- AAK

Z.Nezir Jahmurataj-LVV

Z.Leutrim Myrtezaj-PDK

Z.Izet Koic-BIP

Nga të gjithë anëtaret prezent 30 votë pro, 1 anëtar nuk ka marrë pjesë në votin, miratohet grupi punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

### **5.Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.**

Z.Naim Bytyqi: deshta me ju drejtuar drejtoreshës së kulturës sa i përket inospjesëmarjes së opozites në aktivitete e shumta që i organizon, mirpo ju thatë që mos të folim politikishtë mirëpo aktivitetet përbajnjë politikë. Nëse e marrim pjesëmarrjen e njerëzve në proporcion apo aktivistë të sportit në proporcion me njerëzë politikë shpesh njerëz pjesëmarrësve sportistëve apo fëmijëve nëpër festivale ku unë i konsideroj që shumca e ketyre aktivitetave kanë karakter politikë. Atëherë nuk e di qysh mundet një opozitë me marrë pjesë në këto akt vitete.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: në fakt e jona është t'ju ftojmë të gjithëve dho sa i vlerësoni ju karakteret dhe rolet është çështja e juaj.

Z.Berat Ganiqi: unë nuk fola për sport , unë fola për turizëm. Nuk e di pse ndëi hyri drejtoresha e kulturës rinisë dhe sportit. Shumë e vërtetë kampion je në subvencion që po i subvencionon shokët dhe shoqet e tuaja, vetem nese qelin një shoqatë me lujt kpitasha keni nie i subvencionuar veq a e ki shokë a shoqe. Unë kesh duke folur për turizëm se nuk fola për kulturë sepse e dim që mezi e ke mbajtur një aktivitet të Azem Shkrelit mbas sa e sa viteve. Kur jam opozitë ktu dhe të dëgjoj deri në fund mundesh edhe ti mem dëgju deri në fund, pakënaqësit tuaj shafiq qysh dush. Po thuani opozita po kundërshton ma shumë ke ide se sa kundërshtim. E kush don me pa si kundërshtim edhe je lidhur me inat për atë post që njerëzve tjerë me ju bë dëm edhe veç me i kqyr tutë përafërt me i subvencionu ki qesi përgjigje dhe këtë reagim.

Znj.Xhenet Syka Kelemendi: është vetem opinioni ytë dhe e keni pak vështirë me pranu suksesin.

Z.Nezir Jahmurataj: ne e dimë që zhvillimi ekonomik i ka katër shtylla edhe nuk mundet as kryetari e as drejtori me pasur ndonjë sukses të zhvillimit ekonomik pa u kyq të gjitha lamitë. Janë pjesë hoteleria, industria, bujqësia të gjitha së bashku. Qyteti i Pejës jër me pas sukses duhet me u bë bashkë 4 drejtori sidomos drejtoria e shërbimeve komunale bën pjesë në zhvillimin ekonomik se duhet me i kqyr rrugët duhet me u mundu për me kontribu gjithë së bashku j'a kemi obligim ketij vendi.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe unë po e konceptojë që u tha nga anëtaret e luvendit që nuk ka bë komuna për turizëm. Pjesa e zhvillimit të infrastruktura së zonat e bjeshkëve edhe pjesëve ku

ka frekuentim të t'ristave është bë mjaftë dhe pothuajse një përqindje shumë e madhe e buxhetit ka shkuar në atë drejtim. Mirpo komuna ka bë mjaftë për turizëm ku është në zhvillim e sipër bizneset që operojnë në zonat e turizmit.

Z.Nasret Hajrizi: Inë nuk desha me u thelli sa i perket rportit pasi që e keni përparrë jush. Sa i perket raportit që thashë primatin, ne i kemi statistikat e AK-së të cilat e qesin Pejë shtyllë të turizmit sidomos pjeses malore Ndërsa sa i perket turizmit në Prizeren duhet me ditë që është një ditor ndërsa tek re në Pejë e kemi katër ditor. Ndërsa sa i perket investimeve kapitale, ne si komunë, si drejtori për këto vite kemi investuar më shumë se sa krejt qeveria në komunen e Pejës. Për këto këtë vite asnjë cent se ka jep qeveria e Kosovës në komunen e Pejës në drejtim të zhvillimit ekonomik sidomos Ministria e Linjes që është e zhvillimit ekonomik, dhe kur flasim duhet të flasim me letra dhe me fakte.

#### **5. Shqyrtimi i raportit (informatës) rrëth aktiviteteve të KKSBB-së.**

Nënkyetari Fatmir Asllani: para jush e keni marrë një raport informativ lidhur me planin e punë KKSBB-së për vitin 2025. Ky plan është aprovuar në asamble në fillim të vitit 2025 dhe ne jemi munduar me përpikmëri që t'i mbajmë këto takime sipas ketij plani. Janë diskutuar temat rrëth shëndetësisë, arsimi dhe ambientit në këto tre takime të rregullta që janë paraparë dhe në plan. Janë diskutu edhe temat edhe jashtë raportit. Po ashtu janë thirrur edhe institucionet tjera për raport dhe të gjitha ju kanë përgjigjë këtij raporti. Sipas planit këto tre takime janë paraparë me u mbajtë në gjashtë mujorin e parë dhe janë edhe tre takime në gjashtë mujorin e dytë. Po besojmë që me kohë do të mbërrimë të gjitha pikat t'i diskutojmë. Po ashtu kur ftojmë rrëth sigurisë anëtar të tjerë jashtë institucioneve komunale ju kanë përgjigjë gjithmonë dhe shpresojmë që edhe në këto tre temat e tjera të mbetur do të përgjigjen.

Znj. Hidajete Krasniki: para vetes e kemi një raport informues të KKSBB-së që i paraqiti kordinatori i këtij komisioni. Unë i kam disa pyetje ndoshta edhe disa pakënaqësi në ketë raport që janë paraqit sa kam mund me analizu përpos komandatit të policisë që i ka paraqitur në detaje raportin përsigur në komunën e Pejës. Shqetësuese më është dukur rapporti për shendëtësi dhe arsim është sjella e përsonelit mjekësor, domethënë unë nuk e di qka kanë dashur me thënë apo ndoshta kanë dashtur me potencu se sikur policia një raport për punën dhe angazhimin që e bëjnë punëtoret shëndetësor nëpër të gjitha institucionet e në ketë rast kujdesi parësor ÇMF, AMF dhe në vendet ku puncinj. A është dashur të paraqitet një raport përsigurinë e tyre në vendin e punës dhe sa është përmoshur lista esenciale e terapisë duke pasur parasur që çdo mungesë e rrezikon edhe punën e përsonelit me kry punën e vet. Ndërsa as tek arsimi nuk kam parë ndonjë të detajuar dhe thasi është prap përpos komandatit të policisë. Tek ekzekutivi po shpresojmë që është kohë fushatë rrujë trotuare ndoshta po i vije fundi edhe gjimnazit të Pejës. Sa i perket shpronësimit janë kryer se në ketë mandat kurgjë tjeter s'kemi pas në ketë seancë veç shpronësimë sepse dihet që përfitimet më të mëdha janë tek shpronësimet.

Z.Berat Ganiqi: Raportin e kam lexuar dhe ndoshta ka pas diskutime me të gjatë aty janë diskutuar edhe çështjet që dua me i ngit. Problemi kryesor në Pejë e psh edhe tek raporti i komandantit është duke u bazuar në do vepra penale dhe i ka paraqitur me statistika. Për momentin problemi në Pejjë është komunikacioni. Edhe nuk kemi as shifra të ndeshjeve në komunikacion, as nuk kemi ndonjë shifer a ndonjë plan të ndalimit të motorrave ose motoçikletaveqë i atëkeqësishtë po vazhdojnë në qenëtë të qytetit. Tashmë ka filluar sezona verore

dhe ka bashkëatdhetar më shumë dhe motoçikletat po pengojnë në çoo anë të qytetit. Fatkeqësishtë e kemi një viktimë të aksidentit që ka ndërru jetë sot. Andaj duhet të angazhohemi bashakrishtë edhe policia duhet një angazhim më të madh të policëve në qencër të qytetit dhe ti parandalojnë këto aksidente me fatalitet, sepse javen e kaluar që shkoi patë s'numë aksident me dëme në njerëz por edhe dëme materiale. Kjo është thirrja ime që KKSB-jtë fokusohet më shumë në trajtimin e ketij fenomenit për këto tre muaj të verës.

Z.Drin Veselaj: e kam një pyetje për kryetarn e mbaj mend fushaten e 2013-sës ke qenë shumë i shqetësuar për siguri. Edhe e mbaj në mend një debat televizivë dhe e pa e akuzuar kundër kandidatin edhe i pate thënë që çdo problem që ndodhë ti duhesh si kryetar më qenë ti duhesh si kryetar me qenë prezent. Po ashtu më kujtohet përgjigja e tij që ka thënë se nuk jam prokuror janë instiucionet. Sa here ke qenë prezent ti në ato se çka ka ndodhur në qytetin e Pejës si kryetar edhe pse krejt ketë delegim e ki bë te nënkyetari dhe meresh shumë pak me ketë punë përveq prezencës tënde fizike që e ke përkundrazi ti vetë je kanë ai që gjithë monë ke thënë që s'bën me delegu. Kjo është kompetencë e kryetarit.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: po më vjen keq Drin që sa mandate je e hala s'e ke kuptuar funksionimin e KKSB-së. Unë e udhëheqi KKSB-në Nënkyetari është kordinatorë. Në të gjitha mbëledhjet kam qenë prezent fizikisht e psiqikisht. Nënkyetari është korlinatorë dhe e bë raportin e qatij komisionit të cilin e udhëheqi unë dhe ne jemi bashkë.

#### **7.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar.**

Nuk ka pasur

#### **8.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.**

Z.Feriz Gashi: një pyetje për drejtorin e shëndetësisë. Drejtor keni premtua që prej janarit të këtij viti ka me pas staf të rregulltë në QMF dentistë në Vitomericë. Përvëç disa dentistëve vullnetarëve vullnetarë që e kryjnë punën aty, ki premtuar që ka me pasur? Nuk ka. Edhe ju shumë mirë e dini sa kushtojnë shërbimet përrregullimin dhe ndreqjen e shëmbëve. Unë kam pritur që vërtet ke me mbajtur fjalen edhe ke me siguruar aty ose ke nje shpallë ndonjë konkurës. Kemi nevoj për dentistë në atë ambulantë. E dyta aty ka qenë një laboratori që keni bartë dhe e keni çuar në Novosellë, ju e dini që Vitomericë me rrëthinë ka shumë më shumë banorë nga Novosella. Më lehtë e kanë banorët e Novosellës me ardh në Vitomericë, se sa Vitomericë me krejt banorët e aj me shku në Novosellë. Ke pas premtuar që edhe aty ke ne bë një labrador modern, nuk ka ndodhur as kjo! Pse nuk e di ndoshta na e sqaron. Kurse përrregjutori e arsimit ose kryetari mundet me na ndihmu që shumica e fushave sportive nëpër shkolla janë të shtruar në asfaltë. A ka mundësi që mbi ketë asfallt të jepet një shtresë gome e cila ka me i parandalu shumë rreziq me të cilat ballafaqohen nxënësit. Mendoj që kjo mundet me ndil mu shumë sespe e kam parë në disa fusha. Edhe nëse rrëzohen nxënësit nuk paraet shumë rrezik ose lëndimet kishin me qenë shumë më të vogla.

Znj. Zize Hakaj Veselaj: pyetje për drejtorin e shëndetësisë se kur kemi me u furnizu me barnat që janë më më të rëndësishme përrnjë ambulantë. Po bëhen 5 muaj që në aïnbullantat në Pejë

nuk ka ampull diklofen, dexaton. Unë e di që vin prej Ministrisë së shëndetësisë por ka ka mundësi për rastet emergjente me na i siguru?

Z.Nezir Jamuratq : unë dua me i paraqit do kërkesa para kryetarit dhe drejtorave. Kryetar po punohet kanalizin i i ujравe të zeza me i dërgu në implantin qëndror në Gorozhdevc Raushiqi dhe Loxha. Mos me u vonu me hy edhe Lybeniqi se kanalizimi i ujërave të zeza 70% ndërtu në vitin 99-en është fshat i par që e ka pasme UNDP ne e kemi bë bashkë. Pyetja e parë a është Lybeniqi në ketë hartë të ujравe të zeza a nuk është? E dyta kërkesë është për shtëpinë e fshatit Lybeniq sespe vi in e kaluar ka thënë drejtori dhe as nuk ka filluar dhe nuk ka asnje lëvizje. Po ashtu kemi folur 100 here për rreth rrrotullimin të Raushiqit për Lugën E Baranit është i nevojshem edhe për rreth rrrotullimin në Loxhë këto të dyja janë më të nevojshmet për komunen e Pejës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: kanalizimi Loxhë-Raushiç, deri në Loxhë e kemi përfundu për Raushiç po ka probleme me njerzë. Prej fsh.loxhë janë mbetur edhe 1 mijë metra për me mbri tek derdhja që bëhet në Raushiç. E pastaj për me u lidh edhe Lubeniqi është më lehtë me u kry, por po ka probleme me u përfundu segmenti Loxhë-Raushiç. Kjo rruga që po fol është me ministrinë. Ministria e ka hartu projektin dhe nuk e di tash a e shtin në planifimime buxhetore se me siguri i ka prioritetet tjera. Ndërsa shtegu i shëndetit po besoj që ka me u punu tash deri sa i vjen rendi se grantin e përfomancës po e hupim që dy here spo mundem me fitu kur e fitojmë shtegun kemi me përfundu.

Z.Berat Ganiqi: në mungesë të drejtorit për shërbime publike përgjigjet kryetari, në lidhje me rrugën te çerdhja : vjetër te Pëllumbat e Paqes, një rugë e cila po hapet dhe banorët janë duke e kundërshtuar ndoshta jeni në dijeni. Kryetar kisha propozu që njëher me i ndërpren punimet dhe me u marr vesh ne banorë meqenëswe ata kanë goxha pakënaqësi dhe ketë pakënaqësi tyre duhet me trajtu patjetër. E imja si opozitë o mos me tt'a hënë hiq dhe me me shti në konflikt dhe ja marrim votat aty po megjithëatë demokracia e ka një parim që edhe qytetarët duhen me qenë pjesëmarrës në rrë gullimet në lagje ku bëhen. Edhe një sugjerim për drejtorinë e kulturës pasi që ke fjala tek Faceb ook me pas kujdes me postimet mos me qit qanata e kapuqa duhet me qenë më serioze se është institucionale.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: shumë mirë po me vjen që po j'u bjen ndër mend por ketë punë është deashur me bë kur janë bë hartat zonale. Problemin që e kemi tek çerdhja ku 300 prind i bijnë fëmijet e s'runder me u kthy ne kemi mendu me e zgjidhë duke e bë një rrugë e cila del në Bistricë dhe ajo rrugë është 8 metra e gjonë me dy trotuare nga 1 meter e gjysë dhe është dashur me kalu në për prona private me i kry ato punë, me i kry shpronësimet dhe me dal në atë rrugë. Ajo rrugë është e planifikuar e buxhetuar me kry me bë zgjedhje për prindërit që i qojnë fëmijet në çerdhe.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: sa i perket faqes së komunës është faqja zyrtare më aktive. Jo pse drejtorati është i 'eqantë, por puna që bëhet na obligon që faqja të jetë aktive në promovimin e aktivitetetve kulturore, rinore , sportive që ndodhin në Pejë. Jam jashtëzakonishtë e privilegjuar që faqja jonë përcjellet me një vëmendje të jashtëzakonshme. Rekomandoj ata që kritikojnë

faqen me qëllime politike dhe qëllime të tjera kish qenë mirë që gjithë kritik iesit është mirë të shikohet se çfarë nxënës dhe me çfarë nota janë vlerësuar në shkollat fillore dh : të mesme.

Z.Drin Veselaj: drejtoresha foli për diplomaci kultërore dhe tetari “Istref Beçolli” mundësishtë me kry pa e marrë me diplomaci ndërkombëtare se e kena 20 metra e që g ashtë vjet u mbet duke u shitet. Kshtupe qekjo është diplomacia ndërkombëtare, kombëtare, nacionale me kry punën për çka je aty e thirrme. Meqenëse drejtori Agron nuk është këtu, po i c rejtohem kryetarit shqetësimi i parë është rruga Radavicit e cila është punuar kanalizimi dhe e cuptoj që ata e ka punuar ministria, mirépo komuna i obligon ata operatorë që me kthy në gjer dje të mëparshme rrugën. Gjithashtu një shqetësim tjeter që e kanë ngrit qytetarët është ngritja e trotuarit në rrugën Mbretëresha Teutë, ku nganjëhere e vështirëson edhe ecjen e këmbësorve po ashtu edhe pë bizneset që janë aty është një bllok i jashtëzakonshëm. Mirépo për rregullimin e komunikacionit është duftë me pasur parasysh nese është nevoja me angazhuar një konpani e cila e ka ekspertizen e nevojshme për ketë pjesë sepse me kët levizje që po i bëjmë nuk po mendoj që kemi me zgjidhë ndonjë problem. Unë jam dekalaruar që rrathi te Kondirollt e ka bë njëfar barzie prej që është ndërtu. Përpara ka qenë kolona prej semaforave në drejtim të stacionit të policisë e tani është në të gjitha anët. Po ashtu kam sheqetësim tjeter nga banorët tek xhamia tek gjylfatimi kanë shqetësim për ngushtimin jashtëzakonishtë shumë të rruges.

Z.Islam Husaj: edhe unë e kam një pyetje për drejtorinë e shëndetësisë. Në undvitin e vitit të kaluar është aprovuar një udhëzim administrativ të cilin e ka dërgu ministria e shëndetësisë, Udhëzimi 03/2024 për bashkë-pagesa e që mendojmë që është në kundërshtim me ligjin për shëndetsi. Kjo ngase ligji për shëndetësi i liron disa kategori nga bashkëpagesat, i liron fëmijet, pensionitët, përsonat me aftësi të kufizuar, përsonat me sëmundje kronike, gratë shtatëzëna përsonat me kancer etj.. Kur e kemi parasysh se ligji është më i madh sesa udhëzimi administrativ, unë mendoj që Drejtoria e Shëndetësisë duhet me vepru në ketë rast.

Në Komitetin për shëndetësi e kemi diskutu ketë çështje dhe e kemi dërgu një shkresë tek drejtori i drejtoratit. Problemi ka ardhur se ministria e shëndetësisë në E-Kosova e ka paraqitur një link ku të gjithë qytetarët duhet ta përcaktojnë mjekun e vet familjar. Ky proces i caktimit të mjekut familjar nuk është kryer ende dhe ky udhëzim administrativ që ka ardhur në komuna kishte mundur me u aplikuar atëherë kur ishte kryer procesi i caktimit të mjekut familjar dhe bërjes së listes së pacientëve. Meqenëse Ne ato nuk i kemi, as listën e pacientëve e as zgjedhjen e mjekut familjar. Unë kërkoj që në institucionet shëndetsore të komunës tonë ës respektohet ligji për shëndetësi dhe të gjitha kategoritë të cilat me ligj janë të liruara të mos pa paguajnë pavarsishtë se ku vizitojen. Prandaj unë mendoj që kërkesa është legjitime që të rishikohet edhe njëherë vendimi i drejtorisë i cili është në fuqi, se pacientet duhet të paguajnë nga 5 euro pavarsishtë nga kategoritë e liruara me ligj e me ketë vendim janë të obliguara që të paguajnë.

Problemi tjetër është që banorët e zonave të tjera po kthehen nga institucionet shëndetsore dhe nuk po u ofrohet shërbim shëndetësor. Ata të cilët janë të sinqert dhe tregojnë se ku banojnë vërtetë, atyre nuk ju ofrohet shërbimi. Ndërsa ata të cilët mund t'i gënjejnë punëtoret

shëndetësorë, se lëtu e kam shtëpinë, atyre ju ofrohet shërbimi shëndetësor. Ne jemi larg prej asaj që ta caktojmë mjekun familjar, listen e pacientave, regionalizimin dhe pastaj kur krejt këto të digjitalizohen ose i kemi në kopje të forta atëherë mund të merren edhe vendime të tilla.

Z.Naim Bytyqi: në çështje që deshta me ngrit dhe kjo ka të bëj me shendetin qytetarëve është ekspozimi në diel i pijeve në këto pikat shitëse në parkete. Për ketë çështje kam biseduar edhe me drejtoreshen e inspektoriatit dhe është munduar me qenë aktive mirpo kërkoj edhe nga ekzekutivi të ndil mohet që këto pije mos të ekspozohen në pikat shitëse në diell sepse reziku është shumë i lartë. Athere mendoj se të gjithë duhet të meren me ketë qështje që qytetraët mos të konsumojnë këto pije të ekspozuara në diell.

Z.Berat Ganiqi: u i ë nuk bëra kritik unë jepa sugjerim. Duhet me dallu kritikën prej sugjerimit. Prap më tërheqti kjo fjalë diplomaci kultërorc, artistike. Unë vetem thashë mos bëhen gabime me u vendos kapela e çanta në faqe në Facebook që i perket një institucionit. Ndërsa për urë kryetar nuk kritikoj shumë mirë ke bë e tregova edhe kahjen me dorë pse po e bën urën.

Z.Labinot Panxha meqenëse në fillimi të ketij viti dhe në vazhdimësi e kemi ngritur ketë çështje për bashkëpagesat e qytetarëve të cilët janë detyruar me i paguar edhe përkundër faktit që i ka liruar ligji për shëndetësi dhe udhëzimi administrativë i këtij ligji. Prap është vazhdhu edhe në spitale por edhe në qendrat e mjekësisë familjare të ju meren pagesat qytetarëve të cilët janë liruar. Vetë fjalë në nenin pesë të këtij udhëzimi administrativ, kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruar nga bashkëpagesa dhe me radhë se cilat kategori janë këtu. Ti nuk mundesh me ju marrë pat apo s'pat udhëzim pagesë sespe këta veç janë të liruar. Nese i referohemi shtojcë së ketij udhëzimi administrativ, i rrefrohemi gabim. Sepse aty flet për qytetarët që nuk janë të liruara dhe nuk flet për kategoritë që janë të liruara nga bashkëpagesa. Çësthja tjetër është që me drejtorin jemi konsulltu që banorët e fshtatit Kosuriq apo Çallapek që nuk e gjen ambulancën në Baran të hapur në orën 15:00 vjen në QKMF dhe detyrohet me pagu. Paguan 5 euro dhe ata nuk ja lëshojnë një fletëpagesë qysh duhet por ja lëshojnë një fletë të bardhë të cilën e kam prçzentuar disa herë me një vulë të institucioni. Unë mendoj që kjo çështje duhet me u zgjidhë një here e përgjithmonë dhe shqetësimi i ketyre banorëve, ketyre kategorive me marrë fund.

Znj.Hidajete Krasiqi: për me ju bashkangjité kérkesës së dr.Zizë dhe dr.Islamin jo me plotësu, po sa here e kam diskutuar ketë çështje problemi e ambulantave dhe konkretishtë kur e kam ngritur si problem çështjen e ambullantes në hapjen e ndrimit të dytë, nga drejtori kam marrë përgjigje se nuk ka pacenta dhe për ata nuk mund me hap ndrimin e dytë. Po vijmë në atë pikë kur kam thënë që krijoj kushtet për me pas pacienta e krijimi i kushteve është më së pari me pas terapi. Doktoresha Zizë potencoq që mos me pas një send elementar në ambulantë siç është një diklofen. Ne e diri të gjithë që furnizimi është nga lista esenciale por me mbet gjashtë muaj pa një diklofen atëherë është një keqmenaxhim në planifikimin e listës esenciale. Po ashtu një pyetje tjetër për drejtoin e pata sa është duke u zbatu procedura standarde operative që është aprovar nga Ministria e Shëndetësisë para dy viteve dhe aty qartë shkruhet për secilin intervenim që e tën mjeku apo infermieri. Nuk jam e informuar për shkak se kujdesi dytësor

ende ska përfunduar, por për kujdes parësor është diku para dy viteve që janë doracakët e shpërndam në ambullanta. Edhe një pyetje për drejtorinë arsimit që të kemi një statistikë nga vizitat sistematike për të gjeturat e problemeve shëndetsore të fëmijëve me të cilat ballafaqohemi.

Z.Petrit Loci: po filloj me pyetjen e z.Feriz, sa i përket çështjes së stomatologut në QMF, aty është i punuar. Stomatologja që ka qenë aty ka punuar 3 muaj pas lindjes dhe ka shfrytëzuar të drejten ka marrë pushim pa pagesë, janë mundësitet ligjore që ju jep ligji dhe shfrytëzojnë. Sa i përket laboratorit është e vërtetë ajo që të kam thënë dhe besoj deri në fund të javes do të filloj punë labratori i ri QMF në Vitomericë. Sa i përket listes esenciale është e vërtetë që ka mungesë të disa artikujve bazik. Ku kjo e bën më të vështirë punen në qendrat shëndetsore në zonat rurale. Ne e kemi pas të planifikuar një kontratë për vitin 2025 përfurnizimin e energjente. E kemi zhvilluar si procedurë dhe ne e kemi bërë paramasat e nevojshme nga baranat e raja kryesore. Nese do të ishte për një qender do të ishte më e lehtë por bëhet fjalë përgjithësisht. Ndërsa sa i përket pyetjes së dr.Islami dhe Labi është çështje e theksuar është udhëtim administrativ. Komiteti për shëndetësi e ka dërgu një kërkesë tek unë dhe do ta përcjellë tek Këshilli drejtues në QKMF. Le ta shqyrtojnë dhe nese e shohim të arsyshem ta pezullojnë atë përgjithësisht. Nese ka ndonjë mundësi ta pezullojnë, është doren e tyre që të vendosin me tutje si do ta procesojnë.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: nga muaji tetor i vitit 2024 ne kemi pasur gjatë gjithë kohes kontakte dhe kërkesa nga Ministrinë e Kulturës, rini dhe sportë të cilët në kanë detyruar të pregatisim një tender me të gjitha detajet që Ministria e kultures mbas do të na ndihmonte, sespe ka hapur një tender gjithëpërfshirës përfatot e Republikës së Kosovës. Përpos që nuk ka ndihmuar asgjë vetem jemi mirënjosë që mbas 7 muajve ka gjetur kohen e mirësin me të përgjigjet në emailin që tenderi ka dështuar dhe se përseri do të përseritet. Mbështetje do të përballemi me faktorin kohë, por ju them me përgjegjësi të plotë që teatri do të bëhet me standarde evropiane dhe aq më tepër do t'i shërbejë edhe më shumë rrugëtimi tonë përdiplomaci kulturore, sespe sa më larg të jemi me diplomaci kulturore, aq më larg do të jemi prej integrimeve.

Znj.Vjendita Kelmendi Gërgoci: pyetja ime i drejtohet drejtorit të arsimit. Edhe vitin që lamë pas e kam ngritur çështjen e mungesës së logopedëve në shkolla. Ne çdo ditë hasim në nxënës të cilët kanë probleme në të folur dhe nuk po marin ndihem e duhur profesionale. Ketë vitë akademik nga shtatori a do të ketë në të gjitha shkollat logopedës sëspe ata që janë të punuar nuk mjaftojnë përfshirët e gjitha shkollat e qytetit dhe fshatrave.

Z.Feriz Gashi: drejtorit të shëndetësisë desha t'i them se ju sigurishtë e pranon të drejten e secilit përfshirët me ushtru pushimet sipas ligjit që i takojnë, por banorëve nuk ju intereson shumë kjo. Aty duhet të ketë staf rregullishtë sespe edhe ju vet e thatë që aty e frekuentojnë shumë dhe vet e frekuentoj atë qmf, por po shpresoj që ke me na rregulli ketë problem. Përfshirëtarin një çështje përfshirët kanalin në mes të atyre dy lagjeve Shala dhe Prekaj shumë here nuk e përballon ujin. Ata ujë shpeshëhere po zbrasitet edhe në asfallt. E kam pse që është bë një

interevnim dhe uji që po derdhet shpeshhere po e grym asfalltin dhe po krijohen gropat. Me ke premtu që ke me regullu dhe me zgjeru pak atë kanal. Çka u bë tash kryetar? Çka me ju thënë atyre familjeve të cilëve vet ju ke premtuar?

Znj. Hidajete Krasniqi: nuk e di qka është problemi çka është ky injorim nga ana e drejtorit shëndetësor pyetjet që unë i bëj gjithmonë sa i përket ambullantes në Lugun e Baranit asnjehere nuk kam përgjigje pse nuk bëhet ambullanta në ndrim të dytë e mos të flas për labrador e stomatologë.

Z.Petrit Loci: absolutishtë nuk bëhet fjalë për injorim sespe nuk e kam në përditëshmërinë teme atë shprehi. Po e theksoj edhe njëherë sa i perket ndrimit të dytë kur është vendosur të bëhet qendra e mjeksësisë familjare në krahe ki drejtoreshen kjo ka inssituar me u bë me dy ndërrime dhe ka qenë kërkuesë. Qendra mjeksore në Raushiq e mbulon gjithë territorinë e Lugut Të Baranit. Pra një pacenet nga Baranit mundet me u ndal në Raushit për të marrë shërbim deri në orën 19:00, në Brin e mer deri në orën 15:00. Pasi që nr i pacinetave është shumë i madh që e frekuentojnë qendren në Raushiq, kjo edhe ka qenë arsyja pse është bërë me dy ndërrime qmf Raushiç dhe ka mjet me një ndrim qmf në Baran.

Z.Naser Gega: Po e di kërkësen e juaj znj. Vjenditë dhe i kam bërë përpjekjet e mia, mirpo problemi është që nuk kemi kapacitete buxhetore, mundësi për me i punësuar logoped nëpër shkolla. Edhe pse nevoja shumë e madhe, ne po duhet me i punësuar me ato mundësi çka u kanë lejuar si asistent përfëmijë me nevoja të veçanta edhe nese në mesin e tyre keëmi pasur logoped me i inkorporruar por jo si logoped përfunkësionin çfare kishim ata me kry në shkolla sepse nuk kemi mundësi për se jemi të limituar të numirt të punësuarve.

Meqë u shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën **12:20 h**.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=fuu6o-ZuqNA>

Procesmbajtësja.

z. Donjeta Moçina

